



INITIATIVE FOR AGRICULTURAL DEVELOPMENT OF KOSOVO  
INICIATIVA PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË SË KOSOVËS  
INICIATIVA ZA POLJOPRIVREDNI RAZVOJ KOSOVA



# KULTIVIMI I BIMËVE MJEKËSORE DHE AROMATIKE



Dhjetor 2021



Ky projekt është i financuar  
nga Bashkimi Evropian



**MNE - KOS**

IPA PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR  
MALI I ZI - KOSOVË 2014-2020





Kjo broshurë ka qëllim që sadopak t'i përgjigjëjt kërkesave praktike dhe profesionale të përfituesve tanë dhe fermerëve tjerë kultivues të bimëve mjekësore aromatike.

Botimin e këtij teksti në gjuhën Shqipe Angleze dhe Serbe e ka mundësuar projekti: "Krijimi i vendeve të punës në bujqësi".

Projekti është i financuar nga Bashkimi Evropian përmes programit IPA II të bashkëpunimit ndërkufitar në mes Malit të Zi dhe Kosovës. Aktivitetet e projektit në pjesën e Malit të Zi zbatohen nga Kryeqyteti Podgorica, kurse në pjesën e Kosovës (Pejë dhe Istog), zbatuese e aktiviteteve të projektit është Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës (IADK).

Shënim: Ky botim është realizuar me përkrahjen e Bashkimit Evropian përmes IPA II programi i bashkëpunimit ndërkufitar Mali i Zi – Kosovë 2014-2020. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Inicativës për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës – IADK-së dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i Bashkimit Evropian, apo programit IPA II.





## PËRMBAJTJA

|                                                                 |    |
|-----------------------------------------------------------------|----|
| Hyrje.....                                                      | 5  |
| MENTA ( MENTA PIPERITA L.).....                                 | 8  |
| RIGONI I BARDHË – ORIGANUM HERACLEOTICUM L. FAM. LAMIACEAE..... | 11 |
| HITHËRI - URTICA DIOICA L. FAM. URTICACEAE.....                 | 13 |
| MËLLAGA E ZEZË – MALVA SYLVESTRIS SSP MAURITANICA (L.).....     | 17 |
| CIANI - CENTAUREA CYANUS L. FAM. ASTERACEAE.....                | 20 |
| KALENDULA – CALENDULA OFFICINALIS L.....                        | 22 |
| LULEDIELLI - HELIANTHUS ANNUS L. FAM. ASTERACEAE.....           | 25 |





## Hyrje

### *Informacione të përgjithshme për bimët mjekësore aromatike*

Bimë mjekësore quhen të gjitha bimët që përmbajnë substanca vepruese, të cilat parandalojnë, lehtësojnë ose shërojnë sëmundje të ndryshme. Bimët mjekësore mund të mblidhen ashtu siç janë ose mund të merren nga ato vetëm pjesët e veçanta (si lulet, gjethet, rrënjët e rizomat, frytet, farat, lëvoret, degët, sythet, etj.) që janë më të pasura me



substanca vepruese. Si bima e tërë mjekësore, ashtu edhe pjesët apo organet e saj, në gjendje të tharë, quhen droga mjekësore bimore. Vlera e bimës dhe e drogës mjekësore varet nga lloji dhe sasia e substancave vepruese që ato përmbajnë. Pikërisht për këtë arsye bimët mjekësore dhe organet e tyre mblidhen apo vjelen në periudhën kur janë më të pasura me substanca mjekuese. Kjo kohë, në shumicën e rasteve, përputhet me shkallën më të lartë të zhvillimit të bimës ose të organit të saj. Sasia dhe lloji i substancave vepruese që përcaktojnë vlerën mjekuese të bimës apo të drogës mjekësore bimore varen jo vetëm nga periudha e zhvillimit të bimës, por edhe nga faktorë të tjerë, siç janë, p.sh., toka, klima, mosha e bimës, gjendja e saj, etj.

Dallimi midis bimëve mjekësore e atyre aromatike, është ai i bërë sipas formulimit: Bimët Mjekësore janë ato që përmbajnë lëndë/substanca, që mund të shërbejnë për qëllime kurative (terapeutike) dhe janë parardhëset e molekulave farmaceutike, ndërsa Bimët Aromatike janë ato që përmbajnë lëndë/substanca, që u japin ushqimeve cilësi organo-leptike të veçanta dhe/ose që mund të përdoren në sektor të tjerë të industrisë (pije, kozmetikë, parfumeri).

Bimët mjekësore e aromatike janë përdorur që në lashtësi për përmirësimin e mirëqënies së njeriut, luftimin e sëmundjeve, ruajtjen e dhënien e shijes ushqimeve, në prodhimin e parfumeve, likernave, reçelnave, ngjyruessve ushqimorë, insekticideve, etj.





Përdorimi i madh në industrinë farmaceutike, ushqimore e kozmetike i këtyre bimëve, kërkon që të rritet prodhimi i tyre. Më e nevojshme kjo është për ato bimë që në natyrë gjenden rrallë ose kur ka kërkesa për to më të mëdha se sa gjenden në natyrë.

Prandaj, në disa zona ka filluar edhe kultivimi i tyre, duke rritur prodhimet e të ardhurat dhe duke siguruar sasi të nevojshme, të pavarur nga natyra. Për disa bimë të rralla kjo është më se e nevojshme, pasi nuk përballojnë kërkesat nga tregu. Mbjellja dhe rritja e bimëve mjekësore e aromatike si bimët bujqësore, rrit prodhimin e tyre në nivelet që kërkon tregu, por dhe bën që bimët spontane të ndjehen të "qeta", duke arritur që të shtohen të lira, sepse ato nuk dëmtohen nga vjelja, që ndonjëherë bëhet pa kriter. Kultivimi kërkon hartimin e teknikave të rritjes dhe zgjidhjen e shumë problemeve, që nga zgjedhja e seleksionimi i varieteteve të përmirësuara e deri në paketim e magazinim, sepse ato japin më shumë prodhim dhe bëhen kultura intensive.

***Mbi bazën e sasive të produktit që do kontraktohet kërkohet të sigurohen:***

- Njohuritë mbi biologjinë dhe kërkesat e bimëve, teknikat e rritjes, që nga prodhimi i fidanëve e deri në vjelje.
- Më pas përcaktohen sipërfaqet që nevojiten për të prodhuar sasitë e kërkuara, duke zgjedhur zonat dhe tipet e tokës së duhur për kultivim, që të jenë sa më afër atyre ku rriten në natyrë, të lira.
- Sigurimi i materialeve mbjellëse, duke përcaktuar varietetet dhe njohur veçoritë e tyre.

***Për të arritur sukses në kultivim punohet në disa drejtime:***

- Të ruhen e përmirësohen speciet autoktone, që rriten të lira në natyrë.
- Të hartohen e përmirësohen teknologjitë e kultivimit të tyre.
- Të monitorohen teknikat e kultivimit, për t'u përshtatur bimët më mirë me kushtet tokësore e klimatike të zonave, duke bërë rajonizimin sipas këtyre kushteve dhe cilësive të bimëve.
- Të nxitet prodhimi i qëndrueshëm i bimëve dhe prodhimi biologjik, për të marrë produkte cilësore.
- Të sigurohet cilësia dhe siguria e produkteve, si dhe mbrojtja e bimëve nga sëmundjet e dëmtuesit.
- Të nxitet kërkimi shkencor, për t'u paraprirë problemeve, që mund të lindin.



## Kushtet dhe kërkesat për kultivim


Për kultivim të bimëve mjekësore është e nevojshme të njihen veçoritë biologjike të species dhe specifikat që ka varieteti që do të kultivohet. Mbi bazën e tyre dhe të veçorive të zonës, hartohen praktikatat teknologjike që do të zbatohen. Për këtë, duhet të njihen:

- **Cikli vegjetativ:** Të njihet specia nëse është bimë një apo shumëvjeçare, të përcaktohet perioda e mbirjes, e vegjetacionit, lulëzimit, frutifikimit apo pjekjes së frutave a farave.

- **Kushtet dhe kërkesat për rritje:** Këtu përfshihen kërkesat për temperaturë, ndriçim, lagështi, cilësi të tokës dhe nevojat për ushqime. Çdo specie ka disa pragje të temperaturës, si për mbirje, për frutifikim e rritje normale, ka kufijtë ekstremë të rritjes (minimale e maksimale) dhe ata të dëmtimit. Kërkesat për ujë lidhen me nevojat për sasi sipas vegjetacionit e periudhat kritike. Në kërkesat për tokë përfshihen struktura, përbërja mekanike, thellësia, pjelloria, reaksioni, etj. Në zgjedhjen e tokës është shumë e rëndësishme që toka ku do të kultivohet të jetë në atë zonë ku bima rritet në kushte natyrore, përfshirë këtu lartësinë mbidetare, ekspozicionin ndaj rrezatimit, tipin e tokës, etj.

Mbi bazën e këtyre kërkesave përcaktohet programi i mbjelljeve, si mënyra e shtimit, afati i mbjelljes së farës apo copave vegjetative dhe afati i mbjelljes në fushë (në vendin e rritjes), përcaktohen tokat ku do të kultivohet, gjithashtu lidhet me sigurimin e imputeve të nevojshme, si ujë, ushqime, mjete pune, etj.

***Në vazhdim janë përshkruar teknikat e kultivimit të disa llojeve të bimëve mjekësore aromatike të cilat dominojnë për nga aspekti i kultivimit në Kosovë.***





## MENTA ( MENTA PIPERITA L.)



Menta është bimë shumëvjeçare me lartësi 30 deri 80 cm me trup të degëzuar. Trupi është shkurr, rrënjët janë xhufkore dobët të zhvilluara dhe në tokë krijojnë masën e kërcejve nëntokësor (stolonet), që përdoren për mbjellje.

Gjethet janë me bishta të shkurtër eliptike gjatësore dhe buzët i kanë të dhëmbëzuara me nerva të theksuara të gjatë 4 deri 7 cm, faqja e sipërme e fletëve është me ngjyrë të gjelbër të mbyllur dhe të lëmuar, kurse faqja e poshtme me ngjyrë të gjelbër të ndritshme. Në faqen e sipërme gjenden një numër shumë i madh i gjëndrave të cilat përmbajnë vajra.

Degët e mentës përfundojnë me lulesë të përbërë nga 6 deri 7 lule. Lulet janë të imëta dhe gjenden në maje të degëve të cilat degëzohen nga sqetullat e gjetheve. Lulet janë me ngjyrë të kuqe në roze ose ngjyrë vjollce.

Pjesët që përdoren janë: Gjethet (*Mentha piperitae folium*) dhe Kërcejtë me gjethë (*Mentha piperitae herba*), gjegjësisht vaji eterik (*Mentha piperitae aetheroleum*).

*Mentha piperita* mendohet se origjinën e ka në Evropë si një hibrid i formuar spontanisht nga kryqëzimi midis dy lloje mentash (*Mentha viridis* L. dhe *Mentha akuatica* L.), dhe si e tillë është sterile ndaj edhe mund të shumohet vetëm në rrugë vegetative.

Ka dy forma të *M. Piperita*: *Rubescens*, e njohur si "Italo-Mitcham" ose menta e zezë, me gjethë ngjyrë të gjelbër të errët dhe lule rozë në vjollcë, dhe forma tjetër *Pallescens*, e quajtur rëndom menta e bardhë, me gjethë ngjyrë të gjelbër të çelur dhe lule të bardha. Më së shumti kultivohet menta e zezë kryesisht kultivari anglez "Mitcham", ngase përmbanë më tepër vaj eterik në krahasim me mentën e bardhë. Gjethet e thara të mentës përmbajnë 2-4% vaj eterik kurse herba 1-2%. Më së shumti vaj eterik bima përmban në fillim të lulëzimit.

### Kushtet e suksesit

Nuk ka kërkesa të veçanta ndaj nxehtësisë por temperaturat e ulëta në periudhën e vegetacionit shumë vështirë i përballon. Menta ka preferencë shumë për dritë, kërkon 12-14 orë dritë për të dhënë prodhim të mirë.







Nuk e duron thatësinë sepse kjo bimë ka një sistem të zhvilluar të kërcejve nëntokësor – stolonet dhe ka një sistem rrënjor dobët të zhvilluar. Parapëlqen tokat me strukturë të mirë, të pasura me lëndë organike, tokat ranore, aluviale, me aciditet të dobët deri në neutral kurse tokat e rënda nuk i konvenojnë.

### **Kultivimi**

Menta vazhdimisht kultivohet në qarkullim bimor për shkak të kërkesave të shumta për materie ushqyese. I përshtaten tokat që kanë qenë të mbjellura me kultura mihëse. Si bimë shumëvjeçare në të njëjtën parcelë qëndron për së paku 3 vite, kurse mund të rikthehet pas 3 deri 4 vitesh.

Punimi i tokës - Së pari një lëvrin i lehtë në thellësi 15 cm, kurse në vjeshtë me një lëvrin të thellë deri 30 cm.

Plehu i stallës është mirë të përdoret te parakultura, por kur vendoset drejtpërdrejt para mbjelljes atëherë duhet të jetë jashtëzakonisht i djegur mirë.

Mbjellja - Menta përgjithësisht nuk prodhon fara të afta të mbijnë ndaj edhe mbjellet në mënyrë vegjetative me copa (lastarë) të gjelbra dhe stolone.



Kryesisht menta mbjellet me stolone që merren nga një parcelë mente njëvjeçare. Stolonet mbledhen zakonisht pas vjeljes së dytë, të cilat menjëherë duhet të transportohen në vendin e trapientimit ose të paketohen nëse do të mbahen përkohësisht në ruajtje. Gjatësia e stoloneve nuk duhet të jetë më e shkurtër se 15 cm (të paktën tre nyja). Periudha optimale për mbjelljen vjeshtore është nga mesi i shtatorit deri në fillim të tetorit. Mbjellja vjeshtore ka përparësi se më herët vjen deri të vjelja në vitin tjetër. Stolonet mbulohen me dhë 10 -12 cm dhe këto i qëndrojnë temperaturave deri në -10°C.

Për mbjellje pranverore mund të përdoren lastarë të rrënjëzuar me gjatësi 8-10 cm, dhe kryhet sipas teknologjisë së mbjelljes që zbatohet te bimët e kopshtit. Mbjellja e mentës në pranëverë jepë prodhim më të vogël krahasuar me mbjelljen vjeshtore.

Distanca e mbjelljes janë 60-70x25cm. Nevojiten 1,2-1,5 t/ha stolone.

### **Kujdesi pas mbjelljes**

Aplikohen masat agroteknike si janë: kultivimi, ujitja, të ushqyerit, herra, mbrojtja.



Kositja - zakonisht kryhet së paku dy here gjatë verës, duke i kositur bimët afër sipërfaqes së tokës, mundësisht në mëngjesin e vonë, kur gjethet janë



pa lagështi. Koha optimale për kositje është kur sythat e lueleve janë të dukshme, ndërsa faza e fundit për kositje është fillimi i lulëzimit.

Një kulturë e mirë e mentës mund të prodhoj gjatë dy kositjeve një sasi biomase të njomë prej 25-30 t/ha dhe 25% të kësaj sasive si produkt i thatë (6-7.5t).

Në sipërfaqe të vogla mund të vjelen vetëm gjethet përpara sythëzimit në orët e para të mëngjesit, me dorë, duke i hequr gjethet menjëhere nga kërcelli. Rendimenti i gjetheve është afërsisht 1.2- 1.8 t/ha gjethet të thara.

Tharja - mund të kryhet në formë natyrore dhe nëpërmjet të tharësive artificiale, ku në 3 orët e para temperatura duhet të jetë 50-55°C, e pastaj temperatura zbritet në 38 - 42°C.




Lagështia maksimale e produktit të tharë është 8%. Raporti i tharjes së gjetheve është 6:1, ndërsa i herbës (kërcej me gjethet) 4:1. Raporti gjethet/lastarë në produktin e thatë është 1:1.5. Për një hektar të mentës së kultivuar nxjerren 25 – 40 kg vaj eterik.



Paketimi dhe ruajtja - gjethet e thara të mentës nuk duhet të ruhen gjatë sepse janë shumë higroskopike dhe kështu e thithin lagështinë.

Gjethet me lagështi shumë lehtë e humbin ngjyrën e gjelbër. Bima e thatë duhet të pakëtohet në thasë me shumë shtresa. Masa e tharë ruhet në hapësira të ftohta, të thara dhe errëta.





## RIGONI I BARDHË – ORIGANUM HERACLEOTICUM L. FAM. LAMIACEAE



Rigoni i bardhë është bimë shumëvjeçare, me ngjyrë të gjelbërt, gjysmë shkurre nga familja buzore (Lamiace). Karakterizohet me sistem rrënjor shumë të fuqishëm dhe jashtëzakonisht të degëzuar me shumë rrënjë të imëta. Pjesa mbitokësore karakterizohet nga një numër i madh i kërcejve me gjatësi (60-80cm), të cilët më afër sipërfaqes së tokës janë të drunjëzuar dhe shpesh shtrihen. Gjethet janë të imëta me gjatësi 3-4 cm me bishta të shkurtër kurse lulet me ngjyrë të bardhë në të verdhë dhe krejt bima ka një erë shumë të këndshme.



Në qarkullim vjen si: Pjesa mbitokësore (*Origanum herba*), Gjethi (*origanum folium*), dhe Vaji eterik (*Origanum aetherolum*).

Rigoni është emërtim i zakonshëm për produktin me aromë dhe shije që vjen kryesisht nga llojet e gjinisë *Origanum*. Rigoni i evropian (që shpesh quhet rigoni i kuq ose çaj mali i kuq) e ka prejardhjen nga *Origanum vulgare* L., ndërsa



Rigoni i bardhë (i quajtur rigoni i kuzhinës, rigoni grek ose rigoni i ëmbël) prodhohet nga *Origanum heracleoticum* L. ose *Origanum creticum* L. Në kuptimin e vërtetë të fjalës nuk ka lloje të përcaktuara të rigonit. Fara që tregëtohet ka forma nga më të ndryshmet, të cilat mund të jenë të ndryshme si në shije ashtu edhe në përmbajtje. Llojet me lule të kuqe janë më të buta në shije, ndërsa ato me lule të bardha janë më pikante. Rigoni i bardhë përmban 1-1.5% vajra eterike, e shfrytëzohet veçanërisht si mëlmesë në kuzhinë.



### Kushtet e suksesit

Rigoni është bimë e klimës së nxehtë, më së shumti i përgjigjet terrenit me diell.



Nuk ka kërkesa të veçanta sa i përket tipit të tokës, por megjithatë më së miri ka sukses në toka pjellore, të shkrufta, lymore, aluviale, të përshkueshme, që ngrohen shpejt dhe që janë të pasura me humus. Kur rritet në vende të thata dhe të ngrohta rigoni përmbanë më shumë aromë. Tokat e rënda, të ftohta, të ngjeshura dhe me lagështi të lartë nuk janë të përshtatshme.

### **Kultivimi**

Në të njëjtën sipërfaqe qëndron për 3-5 vite, kurse mund të rikthehet për kultivim në parcelën e njëjtë pasi të kalojnë së paku 3 vite. Si para kultura i pëlqejnë kulturat që e lënë tokën në gjendje të shkruftë (kulturat mihëse). Punimi tokës - duhet të bëhet me kujdes sidomos nëse shkohet me mbjellje direkte të farës në ngastra. Toka duhet të lëvrohet në thellësi së paku 35 cm, menjëherë pas vjeljes së parakulturës, duke shpërndarë paraprakisht 30-40 t/ha pleh stalle të djegur mirë, pasi rigoni do të qëndroj për disa vite në kultivim në atë sipërfaqe.

Mbjellja - Rigoni i bardhë mund të mbjellet në vjeshtë dhe pranverë. Mbjellja mund të kryhet me farë ose fidanë. Në vjeshtë mbjellja kryhet pas shirave vjeshtore edhe atë nga gjysma e tetorit dhe deri atëherë derisa lejojnë kushtet klimatike.

Në varësi të kushteve klimatiko-tokësore më e suksesshme mund të jetë mbjellja me fidanë, ku farat së pari mbjellen në pranverë në fidanishte të zakonshme, kur temperaturat mesatare janë të paktën 15°C. Fidanët janë të gatshëm për mbjellje në fund të majit dhe fillim të qershorit, kur të arrijnë gjatësinë afër 10 cm. Shumimi i rigonit mund të bëhet edhe me kërcej të rrënjëzuar apo pjesë të kërcejve të rinj, të cilët në pranverë merren nga ngastra dhe mbjellen në module derisa të rrënjëzohen dhe shfrytëzohen si fidanë për mbjellje. Distanca e mbjelljes mes rendeve është 70-80 cm, ndërsa mes bimëve në rend 20-25 cm.

### **Kujdesi pas mbjelljes**

Aplikohen masat agroteknike si janë: kultivimi, ujitja, të ushqyerit, hurrja, mbrojtja. Pa marr parasysh faktin se kjo bimë është e përhapur në të gjitha rajonet e thata, ato jashtëzakonisht mirë reagojnë në ujitje.







Ujitja përveç me rastin e mbjelljes së farës apo fidanëve dhe fazës së parë të rritjes së bimëve, duhet të kryhet pas kositjes së parë, por edhe pas kositjes së dytë apo nëse ndodhë edhe kositja e tretë.

Kositja - duhet të kryhet në lartësi atje ku fillojnë gjethet e shëndosha nga 4-5 cm mbi sipërfaqe të tokës. Kositja e parë bëhet në fund të qershorit dhe në fillim të korrikut, kurse e dyta gjatë muajve shtator-tetor. Kositja duhet të kryhet në mot të mirë dhe të thatë. Kositja kryhet kur gjysma e bimëve janë në lulëzim.

Tharja - kryhet në mënyrë natyrore në një hapësirë të errët dhe me ajrim të mirë ose në tharëse artificiale në temperaturë 35-40°C. Trashësia e masës bimore të rignonit të kositur gjatë tharjes nuk duhet të jetë më e lartë se 35-40 cm, dhe kjo shtresë gjatë tharjes natyrale duhet përzier shpesh për të mundësuar një tharje të mirë, përndryshe do të kemi nxirje dhe kalbëzim të rignonit. Tharja në tharëse artificiale gjatë një perudhe të shkurtër është ideale për të arritur një cilësi të lartë të prodhimit. Nga 4-5 kg të masës së freskët fitohen 1 kg pjesë mbitokësore të materies së thatë.



Rendimenti - Në vitin e parë fitohet 1.5-2 t/ha pjesë mbitokësore të materies së thatë. Në vitin e dytë dhe vitet tjera pasuese merret nga 5-7 t/ha. Nga një ha me rigon të bardhë mund të përfitohet 30-40 L/ha vajra eterikë.

## HITHËRI - *URTICA DIOICA* L. FAM. URTICACEAE



Hithëri si bimë spontane është mjaftë e përhapur në vende të ndryshme ruderales, afër rrugëve, në sipërfaqe të ndryshme të tokës djerrinë, afër sipërfaqeve ku ka rrjedhje të ujrave, në male, etj.

*Urtica dioica*, shpesh e njohur si: hithra e zakonshme, hithra therëse (megjithëse jo të gjitha bimët e kësaj specie pickojnë) ose gjethe hithre, ose vetëm një hithër ose thumbues, është një bimë barishtore shumëvjeçare në familjen Urticaceae, që gjendet e shpërndarë në zonat e buta dhe tropikale në tërë botën,





dhe në formë të egër haset deri në 2400 m lartësi mbidetare. Bima përbëhet nga kërcelli që ka seksion katror të mbuluar me gjethe me qime thumbuese. Lul et janë të gjelbra dhe shumë të vogla.

Qimet thumbuese përmbajnë histaminë (1 %) dhe acetilkolinë (0.2-1 %). Lulëzon gjatë pranverës deri në qershor. Farat ruajnë energjinë mbirëse deri në 8 vite. Në mjekësinë popullore hithra njihet si mbretëresha e bimëve mjekësore, për shkak të efekteve të saj pozitive në shërimin e disa sëmundjeve. Përdorimi i kësaj bime gjatë periudhës së pranverës dhe verës ndihmon në pastrimin e gjakut dhe tek të sëmurët me



anemi. Këshillohet që gjatë kësaj kohe të konsumohet sa më shpesh bima e hithrës në formë sallate ose dhe e gatuar në supë ose byrek. Kjo bimë ndihmon edhe në problemet që mund të shfaqen në mëlçi dhe për prodhimin e lëngut në tëmth, si dhe në shumë sëmundje tjera. Si pjesë të tregtueshme përdoret gjethi dhe rrënja e hithrës.

### **Kushtet e suksesit**

Habitati i kësaj bime është klima e butë me të reshura nga 600-800 mm në vit dhe me temperaturë mesatare vjetore 6.5 0C. Hithëra nuk ka kërkesa të veçanta ndaj dritës dhe nxhetësisë, andaj mund të mbillet pjesërisht edhe në ngastrat e mbjella si kulturë "shoqëruese", mund të rritet në diell të plotë apo në hije të pjesshme.

Preferon tokat e pasura me humus dhe të kulluara, ngase rizomet nëntoksore nuk mund të zhvillohen në tokat e forta. Hithëri toleron tipe të ndryshme të tokave me një gamë të gjerë pH, diku nga 5.0 deri 8.0, por i përshtaten vendet me lagështi, derisa në vende shumë të thata bimët mund të luftojnë për të mbijetuar por nuk do të kenë shije, e potencialisht mund të kenë mungesë të fuqisë së tyre si një ilaç bimor.

### **Kultivimi**

Hithëri është bimë shumëvjeçare dhe në të njëjtën parcelë qëndron për 3-5 vite, kurse mund të rikthehet për kultivim në parcelën e njejtë pasi të kalojnë së paku 4 vite. Si para kultura i pëlqejnë kulturat që e lënë tokën në gjendje të shkruftë (kulturat mihëse).

Punimi tokës - Parcela ku do të mbillet hithëra, duhet të sigurohemi që të jetë e pastër nga barojat e këqija. Toka për kultivim duhet të lëvrohet sa më thellë që është e mundur, menjëherë pas vjeljes së parakulturës, duke shpërndarë paraprakisht 30-40 t/ha pleh stalle të djegur mirë, pasi hithëri do të qëndroj për disa vite në kultivim në atë ngastër.



Lëvrimi duhet të kryhet në thellësi 35 cm nëse është e mundur, pastaj duhet të kryhet imtësimi dhe rrafshimi i dheut. Mbjellja - Hithëri mund të mbjellet përmes farave, fidanëve dhe rrënjëve. Nga përvojat e viteve të fundit është treguar më e suksesshme mbjellja përmes fidanëve.

Prodhim i fidanëve më së miri është të bëhet në serra apo fidanishte të ngrohta, duke përdorur kasetat/modulet dhe substratin organik për mbjellje të farave. Mbjellja e farave bëhet në fund të dimrit dhe nëse sigurohen kushte optimale ato mbijnë për dy javë. Fidanët mbjellen në vendin e përhershëm sa më herët në pranverë, sapo toka të mund të punohet.



Mbjellja duhet të kryhet në distancë 60-70 cm mes rendeve dhe 20-30 cm mes bimëve në rend. Për mbjellje të ngastrave me hithri mund të përdoren edhe rrënjët e hithrave që gjenden afër maleve ose fushave, që kanë lagështi më të madhe apo edhe nga ngastrat egzistuese ku është i kultivuar. Mbjellja qoftë me fidanë apo rrënjë mund të bëhet në vjeshtë (shtator-tetor) ose edhe në pranverë (mars-prill).



### Kujdesi pas mbjelljes



Kultivimi mes rendeve dhe mihja - janë ndër masat më të rëndësishme gjatë kultivimit të hithrit të cilat sigurojnë një sipërfaqe të pastër nga barojat si në hapsirat mes rendeve ashtu edhe për rreth bimëve në rend, derisa të arrihet zhvillim i mirë bimëve të cilat dominojnë barojat e këqija. Mihja/kultivimi duhet të bëhet disa herë sipas nevojës, me qëllim të

mbajtjes së tokës së shkruftësuar, pasi që hithëra tokën e ngjeshur nuk e duron. Ujitja - Hithëri ka kërkesa të theksuara ndaj ujit, pasi që konsiderohet si evapotranspirues i mirë. Varësisht gjendjes së të reshurave, aplikohen ujitjet, të cilat janë të rëndësishme sidomos pas kositjeve, për të arritur rritje të shpejtë. Kositja - Kositja kryhet kur bima arrin lartësinë 20-30 cm, deri sa janë të reja bimët, çka për kushtet tona llogaritet ka mesi i prillit. Kositjet tjera zhvillohen atëherë kur bima arrinë madhësinë për tu kositur, por assesi nuk lejohet që bima (kërçelli kryesor) të formon kërcej sekondar. Gjatë vitit mund bëhen 6-8 kositje, në kushte të mira edhe më tepër.



Tharja - Edhe hithëri mund të thahet në mënyrë natyrore nëse prodhohet në sasi të vogël, në hapsira të mbrojtura nga reshjet e shiut dhe rrezatimi direkt nga dielli. Tharja më e mirë kryhet në tharëse artificiale prej 2-3 orëve në temperaturë 55°C dhe pastaj zvogëlohet në 40-45°C.




Rendimenti - Në një ha me prodhimtari të plotë, rendimenti i herbës sillet rreth 6 t/ha masë e thatë. Rendimenti për rrënjë sillet 8-10 t/ha masë e freskët, respektivisht 2.5-4 t/ha masë e thatë. Nëse paraqitet nevoja në treg për rrënjë, atëherë mund të nxirren rrënjët në përfundim të vitit të dytë të zhvillimit të bimës.





## MËLLAGA E ZEZË – MALVA SYLVESTRIS SSP MAURITANICA (L.)



Është një lloj bime jashtëzakonisht e përhapur që gjendet në të gjitha kontinentet, si bimë spontane haset zakonisht skaj rrugëve, në kullosa, oborre, djerrina etj. Vjelen zakonisht lulet dhe gjethet, më parë është vjelë vetëm lloji i egër. Për më tepër se 10 vite ka filluar kultivimi i saj edhe në Kosovë, me qëllim që të sigurohet një kualitet dhe standard më i mirë, nga arrihet të vjelën gjethet dhe lulet të cilat janë më të mëdha krahasuar me llojin e egër. Në rastin e kultivimit për lulet (sepse përdoren edhe gjethet), parapëlqehet specia *Malvae mauritiana*, që ka lule të mëdha, dhe është më e lehtë për vjelje. Në tregun e farërave gjenden zakonisht varietete me gamë ngjyre nga vjollcë e çelur në të errët, si për shembull: 'Sylva' dhe 'Limula', pastaj varieteti 'Krajovy' në Çeki dhe 'Dunkelviolette' në Gjermani.

Në qarkullim vijn: Gjethet mëllagës së zezë (*Malvae foli um*), Lulja e mëllagës së zezë (*Malvae flos*) dhe Pjesa mbitokësore e bimës (*Malvae herba*). Është bimë një ose shumëvjeçare me kërcell të degëzuar, të rrumbullakët, vertikal me lartësi deri në 1.5 m, të gjelbër në majë dhe i drunjëzuar në pjesën e poshtme. Rrënjët janë boshtore, të degëzuara dhe dobët të zhvilluara. Gjethet kanë madhësi të ndryshme në bazë më të mëdha, duke shkuar kah maja madhësia e tyre zvogëlohet. Lulet zhvillohen në sqetull të gjetheve të cilat kanë ngjyrë të mbyllur vjollce.



Lulëzojnë në një periudhë të gjatë kohore nga maji deri në tetor në vjeshtë. Në vendet me klimë të ftohtë kultivohet si bimë njëvjeçare, ndërsa në vendet me klimë të butë si dyvjeçare dhe shumëvjeçare. Në vendin tonë zakonisht kultivohet si bimë njëvjeçare, me qëllim të kemi një sukses më të sgurt të prodhimit.

Gjethet dhe lulet e mëllagës së zezë përmbajnë glikozide deri në 10%, pastaj tanin, acide organike, etj. Përdoret si bimë mjekësore, si çaj gjatë ndezjeve të rrugëve të sipërme të frymëmarrjes si dhe zbutës i kollës.





### Kushtet e suksesit

Si e egër gjendet kudo, kurse si e kultivuar ka sukses në tokat që i ekspozohen diellit dhe janë të mbrojtura nga erërat. Mund të kultivohet edhe në zona kodrinore-malore. Nuk ka kërkesa të veçanta dhe mund të kultivohet në tipe të ndr yshme të tokave, por më shumë i përshtaten tokat e lehta me strukturë të mirë me pjellori dhe regjim të mirë ujor dhe ajror, derisa nuk janë favorizuese tokat e ngjeshura.



### Kultivimi

Si bimë njëvjeçare mund të kultivohet në qarkullim, por e duron mirë edhe monokulturën. Në të njëjtën sipërfaqe mund të kultivohet 3 – 4 vjet, kurse si parakulturë i përshtaten kulturat mihëse, derisa duhet shmangur parakulturat e familjes së sajë (malvace) si është mëllaga e bardhë.

Punimi i tokës - Punimi themelor në vjeshtë kursea ai sipërfaqësor në pranverë pak para mbjelljes së farës ose mbëltimit të fidanit. Duhet kushtuar vëmendje të duhur përgatitjes sa më të mirë të tokës sidomos në rastin e mbjelljes së drejtpërdrejt të farave. Si kulturë me rritje intensive për një kohë relativisht të shkurtër zhvillon masë të madhe vegjetative, por ka edhe lulëzim të pandërprer gjatë tërë vegjetacionit, për këtë ka ndikim shumë të rëndësishëm që me rastin e lëvrimin themelor të tokës paraprakisht të shpërndahen afërsisht 50t/ha plehë stalle (organik).

Mbjellja - e mëllages mund të bëhet direkt me farë apo përmes prodhimit paraprak të fidanëve në fidanishte të ndryshme. Mbjellja e drejtpërdrejtë me farë kryhet në fillim të prillit, në distancë në mes rendeve 70-80 cm, kurse brenda rendit 20-30 cm, ndërsa thellësia e mbjelljes së farës rreth 2 cm, ku për 1 ha nevojiten 2-3 kg farë.



Mbjellja përmes fidanit bëhet duke mbjellur farat në lehë të ngrohta apo edhe të ftohta në varësi të planifikimit të kultivimit, ose serra për prodhim të fidanëve. Farat mund të mbillen në fund të shkurtit ose fillimi marsit.





## Kujdesi pas mbjelljes

Aplikohen masat agroteknike si janë: kultivimi, ujitja, të ushqyerit, herrja, mbrojtja. Mëllaga ka nevojë për ujitje, veçanërisht në fazat fillestare. Reagon mirë në ujitje në mot të thatë. Lagështia e tepërt ka ndikim negativ dhe ndikon në paraqitjen e ndryshkut dhe sulmon gjethet. Ujitja duhet kryer gjatë orëve të freskëta të ditës.

Vjelja - Fillon nga qershori deri vonë në vjesht (tetor). Zgjatja e vjeljes varet nga kushtet klimatike dhe lagështia e tokës gjatë verës. Vjela e luleve nuk mund të mekanizohet dhe për këtë vjelja me dorë e luleve kërkon fuqi punëtore jashtëzakonisht të madhe dhe për një perudhë bukur të gjatë (4-5 muaj). Vjeljet duhet të jenë të përditshme, ngase duhet vjelur lulet me petale të hapura, të cilat brenda ditës palosen dhe humbin cilësinë. Përveç luleve nga korriku fillon edhe vjelja e gjetheve, por jo në masë të madhe që të pengohet prodhimi i luleve.



Ndërsa kur mëllaga është e destinuar për prodhimin e gjetheve, kositja e bimëve bëhet gjatë verës në periudhën intensive të rritjes vegjetative kur lastarët ende nuk janë drunjëzuar dhe kanë arritë lartësinë 30-40 cm.



Tharja - Lulet pas vjeljes më së miri është të thahen në tharëse artificiale në temperaturë deri në 40°C. Në kushte natyrore tharja duhet të kryhet në hapësirë të mbrojtur nga rrezatimi direkt diellor dhe reshjet e shiut. Edhe gjethet mund të thahen në mënyrë natyrore duke mos i ekspozuar në rreze të diellit dhe në vende ku depërton lagështia, më së miri thahen në tharëse artificiale në temperaturë

40°.

Rendimenti - i luleve sillet 2-3 t/ha, ndërsa i gjetheve të thara mund të jetë shumë variabil dhe varet prej mënyrës së planifikimit të prodhimit nga bima (lule, gjethe, të dyja së bashku). Për të fituar 1 kg lule të thara janë të nevojshme 7-8 kg lule të freskëta, kurse 5-6 kg gjethe të freskëta dhënë 1 kg gjethe të thara.



## CIANI - CENTAUREA CYANUS L. FAM. ASTERACEAE



Ciani është bimë barishtore një ose dy vjeçare që arrinë lartësinë e rritjes nga 40-90 cm, me kërcell të degëzuar me ngjyrë gri-jeshile. Njihet edhe si kokoçeli i kaltër dhe kultivohet për lulet e tij, që në varësi të varietetit mund të jenë me ngjyra të ndryshme. Duhet të zgjedhen varietetet me lule të plota që përdoren edhe për zbukurime. Veç cianit të egër shoqëria tregtare angleze CN Seeds ka komercializuar varietetet: 'Black Ball', 'Blue Boy Pinkie', dhe 'Red Boy', si dhe një 'Special Mixed', që arrijnë lartësinë një metër.

Gjethet janë heshtake dhe të gjata 1-4 cm. Lulet janë zakonisht me ngjyrë të kaltërt të mbyllët dhe të reditura në kokën e lulës (kaptina) me diametër 1,5-3 cm. Pigmenti blu është protocianina, e cila në trëndafila është e kuqe. Lulëzon gjatë gjithë verës. Gjethet e poshtme janë në formë heshtore të plota, me dhëmbë ose pëndore të prera në një-tre segmente në çdo anë. Ciani përmban një gamë të gjerë të përbërjeve farmakologjike aktive, të tilla si flavonoide, antocianina dhe acide aromatike. Sidomos koka e luleve gjen zbatim në ilaçet bimore, por gjethet dhe farat përdoren gjithashtu për qëllime farmakologjike, megjithëse në një masë më të vogël. Në veçanti, ekstrakte nga kokat e luleve kanë veti anti-inflamatore të përdorura në trajtimin e inflamacioneve të vogla të syve.



### **Kushtet e suksesit**

Ciani duhet të kultivohet në kushte të diellëzimit të plotë, në toka të ekspozuara mirë, ndonëse iu reziston edhe ngricave. Parapëlqen toka të lehta dhe të kulluara mirë, pjellore por të varfëra me kalcium.

### **Kultivimi**

Ciani kërkon të vëhet në qarkullim bimor ngase nuk e pranon monokulturën. Si parabimë të pëlqyera janë drithërat, perimet, leguminozet, bimët foraxhere.

Punimi i tokës - Preferohet një punim bazë i tokës në thellësi prej 30-40 cm në vjeshtë, përderisa në pranverë para mbjelljes ndiqet nga një punim plotësues në thellësi prej 20-25 cm, e pastaj sipas nevojës me punimet sipërfaqësore pak para mbjelljes së farës apo fidanëve, si është diskimi, frezimi etj.



Bima reagon shumë mirë në plehërimin me plahëra organike, dhe për këtë preferohet të shpërndahen gjatë punimit të tokës 25-30 t/ha pleh stalle të djegur mirë.

Mbjellja - e cianit mund të bëhet drejtpërdrejt me anë të farës apo përmes prodhimit paraprak të fidanëve. Fara mbjellet në pranverë gjatë fundit të marsit dhe gjatë prillit, në distancë mes rendeve 60-70 cm. Mbas mbirjes kur bimët arrijnë lartësinë afërsisht 10 cm rrallohen dhe lihen 30 cm larg njëra prej tjetrës.



Është treguar shumë e përshtatshme edhe mbjellja e tre rendeve shumë afër njëri tjetrit (20cm) dhe pastaj lënja e një hapsire prej 70-80 cm për kalim gjatë vjeljeve. Kjo ka përparësi për faktin se me rritjen e bimëve të cianit pengohet zhvillimi i barojave nga mungesa e dritës, lehtësohet vjelja dhe bimët nuk dëmtohen gjatë kalimeve të shpeshta nga vjelësit. Mbjellja përmes fidanëve bëhet duke organizuar mbjelljen e farave në fidanishte të ngrohta apo të ftohta në varësi të planifikimit të mbjelljes, ose në serra të prodhimit të fidanëve. Farat e mbjellura nga fundi i marsit në lehë të ngrohta apo kasta/module, mund të jenë të gatshme për mbjellje në fushë të hapur për një perudhë prej 30-35 ditëve, kur të kenë të formuar 6-8 gjethe. Në zona me erëra të forta është i nevojshëm të vendoset sistemi mbështetës për lidhjen e bimëve, që të pengohet shtrirja e tyre.

### Kujdesi pas mbjelljes

Aplikohen masat agroteknike si janë: kultivimi, ujitja, të ushqyerit, herra, mbrojtja. Ciani ndonëse i përballon mirë thatësinë, megjithatë për të arritur një prodhim të sigurt janë të nevojshme ujitjet në fazë të caktuara gjatë kultivimit, në varësi të kushteve klimatike. Kërkesat më të theksuara për ujitje i ka në fazën e mbirjes dhe lulëzimit. Ujitjet



ose reshjet në prag të vjeljes, dëmtojnë cilësinë e cianit. Ujitja duhet kryer gjatë orëve të freskëta të ditës. Vjelja - fillon në qershor dhe zgjat deri në shtator. Për të ruajtur sasinë e vajit eterik, preferohet që vjelja të bëhet në mbrëmje. Kaptinat lulore këputen me dorë, 2-3 herë në javë dhe vjelja zgjat afërsisht 10 javë. Rendimenti - i kaptinave të thara sillet 3-4 t/ha ose 1.5-2 t/ha petale të pastra. Raporti i tharjes së luleve është 6-7:1.





## KALENDULA – CALENDULA OFFICINALIS L.



Kalendula është bimë njëvjeçare rrallë dyvjeçare, e ka prejardhje prej Mesdheut, e cila është përdor edhe në kohërat e lashta nga popujt e vjetër si bimë mjekësore. Kultivohet për kokat e lulesave të saj. Në treg ka kultivar të përzgjedhur si për madhësinë e kaptinës së lules, ngjyrës së luleve, madhësisë së bimëve, etj. Më i rëndësishmi është kultivari tetraploid 'Palmen', me lule të dyfishtë dhe i pasur me pigmente, i seleksionuar në Çekosllovakia, që ka çuar në rritje të prodhimit si në sasi ashtu edhe në cilësi, prej të cilit më pas janë krijuar varietete të ndryshme, si nga lartësia e rritjes, madhësia e luleve dhe nuanca të ndryshme nga e verdha në të portokalltë. Rekomandohet përdorimi vetëm i kultivarëve me ngjyrë lulesh të verdhë në portokalli të thellë, pa ngjyrën kafe në qendër.

Bimët e kultivuara kanë lartësi 60-80 cm. Kanë rrënjë boshtore me kërcell të drejtë. Në majë të degëve gjenden lulesat. Kalendula lulëzon nga qershori deri në paraqitjen e ngricave vonë në vjeshtë. Pjesët e përdorëshme të kalendules janë lulet, të cilat të thara kanë 0.02% vajra eterike.



Më shumë përdoret në mjekësinë popullore se sa në mjekësinë shkencore. Në mjekësinë popullore përdoret për shërimin e plagëve dhe për përfitimin e çajrave të ndryshëm. Nga lulesat nxjerret ekstrakti, i cili përdoret për uljen e sasisë së kolesterolit në gjak.

### Kushtet e suksesit

Në sajë të përshtatshmërisë së mirë klimatike ka një arel të gjërë si në zona të ftohta ashtu edhe në ato të nxehta. Ka sukses në kushte të ndryshme klimatike por më së shumti, ka sukses në klimë të nxehtë dhe të lagësht. Mund të kultivohet edhe në zona kodrinore, deri në 600 metra lartësi mbidetare. Duhet të kultivohet në toka me karakteristika të mira fiziko-kimike. Nuk i duron tokat e rënda, të lagështa dhe të varfra. I përshtaten tokat e shkrifta dhe që ngrohen lehtë, dhe që kanë ajrim dhe kullim të mirë, me një shkallë të mjaftueshme të lagështisë, por jo edhe luginat me lagështi dhe ajrim jo të mirë, ngase mund të shfaqen infeksionet nga hiri.





## Kultivimi

Duhet të kultivohet në qarkullim bimor dhe rekomandohet që të mos kultivohet më shpesh se një herë në 4-5 vite në të njejtën sipërfaqe, dhe të mos jetë pjesë e skemave të qarkullimit intensiv me kultura tjera të ndjeshme si janë luledielli dhe kolza. Parakultura më të përshtatshme janë bishtajorët, kulturat mihëse dhe drithërat.



Punimi i tokës - Në vjeshtë kryhet punimi bazë i tokës në thellësi 30-40 cm duke shpërndarë paraprakisht 40-50 t/ha plëhra organike, kurse punimi sipërfaqësor në pranverë pak para mbjelljes. Mbjellja - Në prodhimtarinë e kopshtit të kuzhinës kultivohet me fidanë, kurse në prodhimtarinë e gjerë me mbjellje direkt më farë. Mbjellja e farës

bëhet me makinë, në distancë mes rendeve 60-70 cm, dhe 25-30 cm mes bimëve në rend, thellësia e mbjelljes së farës 2-3 cm, mbjellja kryhet në fund të marsit ose fillim të prillit. Nevojiten 6-8 kg farë për ha, kurse mbirjet e para paraqiten 15 ditë pas mbjelljes së farës. Rekomandohet edhe mbjellja e 3-4 rendeve pranë njëri tjetrit (afër 20 cm) dhe pastaj lehet një hapsirë prej 80 cm për të mundësuar vjeljen më të lehtë.



Mbjellja mund të bëhet edhe përmes përgatitje paraprake të fidanëve, në fidanishte të ndryshme, ku farat mbjellen gjtë fundit të shkurtit dhe fillimit të marsit.

## Kujdesi pas mbjelljes

Sikurse tek bimët tjera masat e kujdesit duhet të jenë të rregullta gjatë tërë vegjetacionit me qëllim që toka të mbahet e shkriftë dhe të mënjanohen barojat.

Në fazën e mbirjes apo zënies së fidanëve, si dhe para lulëzimit, kalendula është më e ndjeshme ndaj mungesës së ujit. Po ashtu ujitjet duhet të bëhen sidomos kur kemi thatësi për një periudhë të gjatë kohore. Ujitjet ose reshjet në afërsi të vjeljes dëmtojnë cilësisë e kalendules, derisa ato në korrik dhe gushtë e zgjasin periudhën e lulëzimit.





Vjelja - Duhet të filloj kur bimët kanë një numër të mjaftueshëm të luleve për vjelje. Kalendula ka një lulëzim të vazhdueshëm nga fillimi i qershorit e deri në paraqitjen e ngricave në vjeshtë. Vjelja mund të përsëritet çdo dy apo tri ditë, në përputhje me ritmin e lulëzimit, dhe nëse lulet vilen vazhdimisht, do të mundësohet formimi i luleve të reja, ku do të merren 20-50 lule nga një bimë. Mblidhet e tërë kaptina lulore, me diametër 3-5 cm, duke i këputur në vendin e lidhjes së saj me bishtin. Varësisht nga



specifikimet e produktit, petalet mund të shkëputen nga kaptinat.



Tharja - Tharja duhet të jetë e shpejtë me qëllim që të përfitohen lule me përmbajtje të lartë të të karotenoideve dhe flavonoideve, që në thelb pasqyrohet në ruajtjen e ngjyrës portokalli të kaptinave. Duhet shmangur ekspozimi i gjatë në

diell i produktit. Lulet mund të thahen në formë natyrore në shtresa të holla në vende në hije e me rymim ajri. Tharja në tharse artificiale bëhet menjëhere pas vjeljes, duke i tharë në fillim në temperaturë më të larta (50-600C) për të eliminuar me shpejtësi vesën, dhe më pas ulet në 35-400C. Lagështia e produktit të tharë duhet të jetë nën 10%, në të kundërtën kalendula mund të kalbet brenda pak ditësh. Pranohen vetëm llojet me lule të plota me ngjyrë të verdhë të nderur deri në portokalli (mesi mos të jetë ngjyrë kafe). Produkti i tharë duhet të ambalazhohet menjëhere pas tharjes në thasë plastik ose thasë letre me shtresa.



Rendimenti - i kaptinave lulore të freskëta është afër 6-10 t/ha, kurse rendimenti i thatë është 20-25% të asaj të freskët. Raporti është 5-6 kg e njomë për 1 kg të tharë.



## LULEDIELLI - HELIANTHUS ANNUS L. FAM. ASTERACEAE



Luledielli është bimë njëvjeçare nga familja Asteraceae. Për shkak të veçorisë së saj të përcjelljes së diellit me kokën e saj në pothuajse të gjitha kulturat që nga koha antike emri i saj krijohet me bashkimin e fjalëve diell dhe lule. Luledielli mjekësor kultivohet për lulet e saj përkatësisht petalet e luleve, në dallim prej lulediellit të zakonshëm, që kultivohet për prodhimin e farave. Kultivarët e lulediellit mjekësor dallojnë nga luledielli i zakonshëm në formë dhe strukturë të kërcellit dhe numrit të luleve. Kultivarët e Lulediellit mjekësor, karakterizohen me kërcell të degëzuar ku secila degë formon lule, respektivisht kupa të luleve. Emërtimet e kultivarëve varen nga seleksionuesit. Një prej kultivarve që lulen e saj e formon të mbushur me petale është "Teddy Bear" dhe gjatësia e saj është rreth 80 cm.

Luledielli mjekësorë është bimë barishtore njëvjeçare, që arrinë një lartësi 60-100 cm. Kërcelli rritet shpejt dhe degëzohet shumë duke formuar kokat e lules. Në një kërcell janë të grupuara deri në 15 koka të luleve, diametri i të cilave është më i vogël se të luledielli i zakonshëm. Lulëzon nga fillimi i korrikut dhe deri në tetor varësisht klimës ku rritet. Gjethet janë ovale në formë zemre, relativisht të mëdha dhe me maja të theksuara.



Petalet e lulediellit mund të përdoren si përbërës ushqimi në supa, sallata ose si një zbukurim për ëmbëlsira dhe biskota për të shtuar ngjyrën dhe aromën e recetave. Për më tepër, petalet e thara të lulediellit janë një përbërës i shkëlqyeshëm për përzierjen e çajit bimor. Petalet e lulediellit u përdorën si çajra bimorë në ilaçin antik iranian dhe kinez për të shëruar plagët, për të ulur presionin e gjakut dhe për të forcuar stomakun.

### Kushtet e suksesit

Luledielli kultivohet në kushte të diellëzimit të plotë, ngase edhe emri i saj përkon me formën e ngjashme që kanë kokat e luleve me diellin, dhe kanë veti të kthehen nga dielli. Temperaturat optimale për rritje dhe zhvillim janë 20-25°C.

Toka - Parapëlqen toka të thella dhe të pasura me lëndë organike, sidomos ka kërkesa për përmbajtje të lartë të kaliumit, si dhe toka ku bimët do të jenë të ekspozuara ndaj dritës së plotë të diellit. Toka e kulluar mirë është gjithashtu një kërkesë absolute për çdo lloj luledielli

### Kultivimi

Duhet kultivuar në qarkullim bimorë ngase ka një rritje shumë intensive dhe formon një masë të madhe mbitokësore, duke nxjerrë sasi bukur të mëdha të lëndëve ushqyese nga toka.



Si parabimë të pëlqyera janë drithërat, perimet, leguminozet, bimët foraxhere. Punimi i tokës - Preferohet një punim bazë i tokës në thellësi prej 35-40 cm në vjeshtë, përderisa në pranverë para mbjelljes ndiqet nga një punim plotësues në thellësi prej 20-25 cm, e pastaj sipas nevojës me punimet sipërfaqësore pak para mbjelljes së farës apo fidanëve, si është diskimi, frezimi, etj. Bima reagon shumë mirë në plehërimin me plahëra organike, dhe për këtë preferohet të shpërndahen gjatë punimit të tokës 25-30 t/ha pleh stalle të djegur mirë.

Mbjellja - Luledielli mjekësorë kryesisht mbjelljet direkt me farë në parcel ku zakonisht kultivohet në distanca 80-100 cm mes rendeve dhe 30 cm mes bimëve në rend, distancat ndryshojnë sipas zgjedhjes së kultivarit. Kultivari 'Teddy Bear' kultivohet në distanca 80cm x 30cm.



Mbjellja me farë është e thjeshtë dhe bëhet me makina të njejta që mbjellen kulturat mihëse (misri), dhe duhet të bëhet pasi të sigurohemi se i gjithë rreziku i ngricave pranverore ka kaluar. Mbjellen në thellësi 1.5-2 cm, zakonisht gjatë muajit prill. Në sipërfaqe të vogla luledielli mund të mbjelljet edhe përmes fidanëve, i cili prodhohet në fidanishte duke përdorur kasetat/modulet dhe substratin organik për mbjellje të farave.

### Kujdesi pas mbjelljes

Masat e përkujdesit gjatë kultivimit janë mëse të domosdoshme, ngase luledielli kërkon një ekuilibrim të rexhimit uJOR, ajror dhe termik të tokës. Kjo arrihet me masa kultivuese duke luftuar edhe barojat e kqija. Ka kërkesa të theksuara për ujë, bazuar në habitusin e bimës dhe koeficientin e lartë të evapotranspimit. Së paku njëherë në javë duhet të ujitet, por që më saktësisht turnuset e ujitjes rregullohen, varësisht nga kushtet kilamtike që "përcjellin" bimën gjatë vegjetacionit.



Vjelja - Pasi të formohet koka e parë me petale në majë të bimës, fillohet të vjelet pa filluar formimi i farave. Pas sajë fillojnë të formohen/pjeken kokat tjera më poshtë. Së pari koka me petale prehet në parcelë, duke i grumbulluar ato dhe pastaj në shtëpi/magazin bëhet vjelja e petaleve të cilat pastaj dergohen në tharëse, pjesa tjetër e bimës hudhet (përdoret për plehërim të gjelber).



Tharja - Petalet pas vjeljes më së miri është të thahen në tharëse artificiale në temperaturë deri në 40°C. Në kushte natyrore tharja duhet të kryhet në hapësirë të mbrojtur nga rrezatimi direkt diellor dhe reshjet e shiut, të përshtatshme për tharje janë serrat diellore. Rendimenti i petaleve të lulediellit mjekësorë është rreth 1t/ha.







Adresa:  
Sfaraçak  
i Ulët, Nr.11,  
42.000 Vushtrri,  
Kosovë

*Te jetojmë nga toka dhe puna jonë*

[www.iadk.org](http://www.iadk.org)  
[info@iadk.org](mailto:info@iadk.org)  
[facebook.com/iadk.org](https://facebook.com/iadk.org)  
+383 49 777 046  
+393 44 777 036